Kronikë

Mashtroi administratorin e një biznesi në Librazhd dhe i mori paratë, arrestohet 32 vjeçari

Një 32-vjeçar është vënë në pranga nga policia, pasi përmes mashtrimit i ka marrë një shumë parash një shtetasi.

Foto Ilustruese

Redaksia
4 Maj, 10:34 | **Përditësimi: 4 Maj, 10:59**

Share

Një 32-vjeçar është vënë në pranga nga policia, pasi përmes mashtrimit i ka marrë një shumë parash një shtetasi.

Administratori i një biznesi në Qukës të Librazhdit kallëzoi në policia se ishte mashtruar nga një person, për dhënien e një shume parash. Policia organizoi punën dhe bëri të mundur kapjen në flagrancë të autorit të mashtrimit, shtetasin K.P., 32 vjeç banues në Lezhë.

> *'Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare të DVP Elbasan, si rezultat i veprimeve hetimore dhe operacionale që u kryen menjëherë pas kallëzimit të administratorit të një biznesi në fshatin Qukës, Librazhd, se ishte mashtruar nga një shtetas, për dhënien e një shume parash, kanë organizuar punën, dhe si rezultat kanë kapur dhe kanë arrestuar në flagrancë autorin e dyshuar të rastit, shtetasin K. P., 32 vjeç, banues në Lezhë.', thuhet në njoftimin e policisë.*

LEXO EDHE:
ERE heq pezullimin, rinovon licencën e 'ECO Elb' për inceneratorin e Elbasanit

Më datë 2 maj 32-vjeçari mashtroi F.Rr., 56 vjeç, duke i marrë një shumë parash.

Policia kreu kontrolle në shtëpinë e 32-vjeccarit në Lezhë dhe gjeti dhe sekuestroi një municion luftarak dhe një thikë, të cilat do të dërgohen për ekzaminime.

> *'Ky shtetas, dyshohet se më datë 02.05.2024, nëpërmjet mashtrimit, i ka marrë një shumë parash, shtetasit F. Rr., 56 vjeç.*
>
> *Gjatë kontrollit në banesën e 32-vjeçarit, të kryer në bashkëpunim me stukturat e Policisë Lezhë, janë gjetur dhe sekuestruar municion luftarak dhe 1 mjet prerës (thikë), të cilat do të dërgohen për ekzaminime.', vijon më tej njoftimi.*

Ndërkohë materialet proceduriale i janë kaluar Prokurorisë.

G.K/M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Arrestime | librazhd | Elbasan

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet prokurorëve të SPAK-ut t'u jepet e drejta e rikandidimit?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Mbrojtja e mjedisit, Rama paralajmëron ligj të ri për menaxhim e integruar të mbetjeve
1 Maj, 12:28

Iu gjetën 35 doza kokaine gati për shitje në automjet, arrestohet në flagrancë 32-vjeçari në Fier
30 Prill, 12:34

Tiranë, sherr me armë të ftohta, vihet në pranga një person! 34-vjeçari përfundon në spital
30 Prill, 10:34

Vranë bashkëmoshatarin e tyre në Gramsh, Gjykata e Elbasanit jep dënimin për 4 adoleshentët! 46 vite burg në total
Ronaldo Gjoshi
29 Prill, 18:40

VIDEO/ Lëvizja e tregut aktual, tregtarët e Belshit në protestë, hyjnë me forcë brenda bashkisë
Ronaldo Gjoshi
29 Prill, 11:19

Goditi me çekiç në kokë të dashurin e ish-partneres, arrestohet shqiptari në Itali
29 Prill, 09:31

Plas sherri në lokalin në Elbasan, pasi pinë alkool, 3 të rinjtë rrahin të miturin! Kamarieri dhunon 18-vjeçarin! Në hetim pronari
28 Prill, 16:52

Kryen parakalime të gabuara në dalje të autostradës Tiranë-Elbasan, gjobiten 18 shoferë (VIDEO)
28 Prill, 16:20

Arrestohet njëri prej autorëve të konfliktit në Peqin, ishte tentativë vrasjeje, i pranishëm ishte dhe kryebashkiaku
27 Prill, 11:12

U arrestuan për atentatin e dështuar ndaj Otit të Elbasanit, SPAK kërkon pushimin e hetimeve për miqtë e Erjon Alibejt
Keti Banushi
26 Prill, 17:24

Shkodër, kryente manovra të rrezikshme me automjetin e vjedhur, arrestohet 37-vjeçari
25 Prill, 16:53

Poeti arbëresh që ruajti traditat flet shqip në Përrenjas: Nuk mjafton një jetë për nostalgjitë e mëdha
Ronaldo Gjoshi
25 Prill, 13:59

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje